

	STANDARDET E SIGURISË SË OPERIMIT	PO-KO-007
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 1 nga 14</i>

Standardet e Sigurisë së Operimit

	Përgatiti	Kontrolloi	Aprovoi
Emri i Kompanisë	KOSTT	KOSTT	ZRrE
Data	28.02.2011	28.02.2011	28.01.2011

	STANDARDET E SIGURISË SË OPERIMIT	PO-KO-007
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 2 nga 14</i>

PËRMBAJTJA

1	Hyrje	4
2	Definicionet	4
2.1	Sistemi i Transmisionit	4
2.2	Qarku	4
2.3	Kriteri ‘N-1’	5
2.4	Operimi i sistemit në kushtet normale	5
2.5	Operimi i sistemit në kushte të vështira atmosferike	5
2.6	Kufijtë e papranueshëm të tensionit	5
2.7	Ndryshimi i shpejtë i tensionit	5
2.8	Mbingarkimi i papranueshëm i pajisjeve	5
2.9	Informata të përgjithshme	6
3	Operimi i Sistemit të Transmisionit	6
3.1	Rregulla të përgjithshme	6
3.2	Kriteret e operimit normal – Sistemi 400 dhe 220 kV	6
3.2.1	Parimet e përgjithshme	6
3.2.2	Përmbushja e kriterit ‘N-1’	7
3.3	Kriteret e operimit normal në nivelin 110 kV	7
3.3.1	Parimet e përgjithshme	7
3.3.2	Pa mundësia për të përmbushur Kriterin ‘N-1’	8
3.4	Mbingarkesa e stabilimentit	8
3.5	Restaurimi i sigurisë së sistemit pas prishjes	8
3.6	Kushtet e ndërprerjes	9
3.6.1	Rrjeti 400 kV	9
3.6.2	Rrjeti 220 kV	9
3.6.3	Rrjeti 110 kV	9
3.6.4	Operimi në kushtet e ndërprerjes	10
3.7	Restaurimi i sistemit	11
3.7.1	Kërkesat e Kodit të Rrjetit	11
3.7.2	Prishjet permanente	11

	STANDARDET E SIGURISË SË OPERIMIT	PO-KO-007
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 3 nga 14</i>

3.8	Ballafaqimi me mot të lig.....	11
3.9	Pengesat gjate operimit	11
3.10	Kufijtë e tensionit	11
3.10.1	Të përgjithshme	11
3.10.2	Kufijtë e jashtëzakonshëm	12
3.10.3	Kufijtë normal.....	12
3.10.4	Dështimi për të përmbushur kufijtë e tensionit.....	12
3.11	Konfigurimi i zbarrave	12
3.11.1	Të përgjithshme	12
4	Kushtet e Përgjithshme	13
4.1	Procedura e kontesteve	13
4.2	Ndryshimet e standardeve të sigurisë së operimit.....	13
4.3	Rrethanat e paparashikuara.....	13
5	Burimet dhe dokumentet	14

	STANDARDET E SIGURISË SË OPERIMIT	PO-KO-007
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 4 nga 14</i>

1 Hyrje

- 1.1 Ky dokument është hartuar sipas ‘Nenit 16 – Standardet e Sigurisë së Operimit’ të ‘Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit’. Duhet të lexohet në lidhje me Kodin e Rrjetit dhe me Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit.
- 1.2 Ky dokument përcakton një varg kriteresh dhe metodologjish të cilat **OST** duhet ti aplikoj në operimin e **Sistemit të Transmisionit** që përfshijnë teknikat e kostos-benefitit dhe operimin në ndërlidhje me kushtet atmosferike dhe nevojën për shërbimet që ofrohen për rregullimin e tensionit dhe fuqisë reaktive.

2 Definicionet

Në këtë dokument termet e definuara kanë kuptimin si në Dispozitat e përgjithshme (Përcaktimi i termave) të Kodit të Rrjetit, përveç atyre që janë definuar më poshtë.

2.1 Sistemi i Transmisionit

Sistemi i Transmisionit përbëhet nga:

- (a) Linjat 400, 220 dhe 110 kV, transformatorët 400/220 kV, 400/110 kV, 220/110 kV, transformatorët 220/35kV, 220/35/10 kV, 110/35 kV, 110/35/10(**20**) kV, 110/10(20) kV si dhe pajisjet dhe stabilimentet që janë në pronësi të **KOSTT**
- (b) Zbarrat 110 kV dhe ndërprerësit e linjave 110kV, si dhe pajisjet dhe stabilimentet e ndërlidhura në NS Sharri;
- (c) Zbarrat 110 kV, përfshirë fushën lidhëse gjatësore të zbarrave të dyfishta dhe ndërprerësit e linjave 110 kV, si dhe pajisjet dhe stabilimentet e ndërlidhura në NS Trepça.

2.2 Qarku

Qarku është ajo pjesë e sistemit e përfshirë ndërmjet dy ose më shumë ndërprerësve. Mundë të përfshijë transformatorë, linja kablore nëntokësore dhe linja ajrore (largpërçues). Shant-reaktorët dhe **kompensatorët** si dhe zbarrat nuk konsiderohen si

	STANDARDET E SIGURISË SË OPERIMIT	PO-KO-007
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 5 nga 14</i>

qarqe. Udhëzimet për shant-reaktorët dhe kompensatorët trajtohen në seksionin 3.10. Udhëzimet për aranzhmanet e zbarrave përcaktohen në seksionin 3.10.4.

2.3 Kriteri 'N-1'

Kriteri 'N-1' është rregull sipas të cilit sistemi me elementet e mbetura në operim, pas dështimit të një elementi të vetëm të rrjetit (si psh. një linjë e transmisionit, transformator, njësi gjeneruese, ose seksion i caktuar i zbarrave), duhet të jetë në gjendje të akomodoj ndryshimin e rrjedhave të fuqisë në rrjet, të shkaktuara nga ai dështim i vetëm.

2.4 Operimi i sistemit në kushtet normale

Është situata kur **Sistemi i transmisionit** operohet sipas planifikimit të punës së sistemit, duke përjashtuar ndërprerjet e paplanifikuara.

2.5 Operimi i sistemit në kushte të vështira atmosferike

Kushtet atmosferike të cilat ndjeshëm ndikojnë në punën e sistemit (rrisin numrin e ndërprerjeve në sistem për shkak të rrezikut të zbrazjeve atmosferike, erës së fortë, vërshimeve, zjarrit, tërmeteve si dhe kushteve tjera të vështira).

2.6 Kufijtë e papranueshëm të tensionit

Tensioni jashtë kufijve për rrethanat normale ose rrethanat e jashtëzakonshme, siç specifikohet në paragrafin 3.4.2 të **Kodit të Balancit**.

2.7 Ndryshimi i shpejtë i tensionit

Ndryshimi i tensionit i shfaqur në nënstationin e transmisionit rreth një sekondë pas një ndërprerjeje, pas cilitdo ç'rregullim të rëndë për shkak të një prishje dhe i stabilizuar pas veprimit të cilitdo rregullator të tensionit të gjeneratorit.

2.8 Mbingarkimi i papranueshëm i pajisjeve

Është mbingarkimi i cilësdo pjesë të pajisjeve elektrike mbi kapacitetin e specifikuar për kohën e caktuar. Toleranca në mbingarkesë do të lejohet për kohën dhe ciklet e dakorduara të ngarkesës të pajisjes para shfaqjes së prishjes, dhe aty ku është e aplikueshme, për lejimin që mund të merret nga procedurat e miratuara.

	STANDARDET E SIGURISË SË OPERIMIT	PO-KO-007
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 6 nga 14</i>

2.9 Informata të përgjithshme

Përveç kuptimeve të veçanta të detajuara më lartë, fjalët dhe frazat e caktuara më lartë kanë kuptimet vijuese:

- Referenca në gjininë mashkullore përfshijnë atë femërore dhe referencat në njëjës përfshijnë ato në shumës dhe *anasjelltas*,
- Aty ku këto standarde të sigurisë së operimit specifikojnë informatat me shkrim ose konfirmimin me shkrim që duhet të jepet atëherë cilat do mjete të transferit elektronik të cilat mundësojnë që pranuesi të marr informatat – si posta elektronike ose FAX-përmeshin këtë kërkesë,
- Përveç ku thuhet ndryshe në mënyrë eksplicite të gjitha referencat në seksion do të jenë referencat në një seksion në këtë dokument,
- Cilado referencë në një ligj ose rregullore duhet të jetë referencë në atë ligj ose rregullore të aplikueshme në Kosovë, ose pas zëvendësimit të atij ligji apo rregullore do të jetë ligji ose rregullorja e re nga data e hyrjes në fuqi.

3 Operimi i Sistemit të Transmisionit

3.1 Rregulla të përgjithshme

3.1.1.1 Në parim, **sistemi i transmisionit** gjatë tërë kohës do të operohet në kushte normale për të përmbushur **kriterin 'N-1'**. Sidoqoftë, kjo nuk 3.11 aplikohet për elementet specifike 110 kV ku dizajni i sistemit nuk e lejon këtë.

3.1.1.2 Në kushte të jashtëzakonshme të mungesës së furnizimit në Kosovë do të ketë raste të shumta përtej dhe mbi ato të referuara në paragrafin 3.1.1.1 ku kriteri 'N-1' nuk mund të përmbushet gjatë operimit normal. Këto situata trajtohen brenda paragrafeve në vijim të këtij dokumenti dhe janë të detajuara në **Planin Zhvillimor të Transmisionit**.

3.2 Kriteret e operimit normal – Sistemi 400 dhe 220 kV

3.2.1 Parimet e përgjithshme

3.2.1.1 Sistemi i transmisionit 400 dhe 220 kV duhet të operohet në kushtet normale si dhe në kushtet **aktuale** në rast të ndërprerjeve të shkaktuara nga prishjet në **Sistemin e**

	STANDARDET E SIGURISË SË OPERIMIT	PO-KO-007
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 7 nga 14</i>

Transmisionit të Kosovës ose në sistemet fqinje të Interkonekcionit, si në rastet në vijim:

- Linjë ajrore ose kablllo nëntokësore e transmisionit, transformator ose ndonjë kompensator/reaktor i fuqisë reaktive;
- Humbja e një **njësie gjeneruese** ose një furnizuesi të energjisë.

3.2.1.2 Në asnjë rast nuk duhet të ketë :

- Jo stabilitet të sistemit i cili do të mund të shkaktonte ndalje të tërësishme dhe të gjerë;
- Humbje të kapacitetit të furnizimit;
- Mbingarkesë të papranueshme të çfarëdo pajisje primare të transmisionit;
- Tension në kufijte e papranueshëm .

3.2.2 Përmbushja e kriterit ‘N-1’

3.2.2.1 Me kapacitetin ekzistues 400 dhe 220 kV të **Sistemit të Transmisionit** nën kushtet e operimit normal **kriteri ‘N-1’** plotësohet në tërësi për linjat dhe transformatorët 220/110 kV duke përjashtuar rastin e transformatorit 400/110 kV në NS Peja 3.

3.3 Kriteret e operimit normal në nivelin 110 kV

3.3.1 Parimet e përgjithshme

3.3.1.1 Përveç si detajohet në këtë seksion **sistemi i transmisionit** 110 kV do të operohet nën **kushtet normale të sistemit** në rast të një **ndërprerje** të cilësdo nga njësitë e vetme si në vijim:

- Një linjë ajrore ose kablllo nëntokësore e transmisionit;
- Humbja e një **njësie gjeneruese** ose një burimi të energjisë:

3.3.1.2 Nuk duhet të ketë asnjë nga si në vijim:

- Humbje të kapacitetit furnizues;

	STANDARDET E SIGURISË SË OPERIMIT	PO-KO-007
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 8 nga 14</i>

- Mbingarkesë të papranueshme të çfarëdo pajisje primare të transmisionit;
- Kushte të tensionit të papranueshëm;
- Jo stabilitet të sistemit:

3.3.2 Pa mundësia për të përmbushur Kriterin 'N-1'

3.3.2.1 Me kapacitetin ekzistues, **Sistemi i Transmisionit** do të ketë një numër situatash nën kushtet e operimit normal kur jo vetëm **kriteri 'N-1'** nuk mund të përmbushet por gjithashtu edhe e gjithë kërkesa nuk mund të përmbushet. Nën këto rrethana **OST** duhet të operoj sistemin me prioritetet vijuese:

- a) Garantimin e sigurisë së punëtorëve dhe njerëzve të tjerë;
- b) Siguroj që stabilimenti mos të operohet në atë mënyrë që do ta dëmtonte atë;
- c) Siguroj që një ndodhi e vetme të mos shpie në ndonjë ndërprerje të gjerë në Kosovë;
- d) Përmbush sa më parë që është e mundur kërkesën e sistemit;
- e) Mirëmbaj tensionin e sistemit brenda kufijve të specifikuar në **Kodin e Rrjetit**;
- f) Operoj për të përmbushur **kriterin 'N-1'**:

3.4 Mbingarkesa e stabilimentit

3.4.1.1 Mbingarkesa e stabilimentit lejohet për aq sa është brenda kapacitetit afatshkurtër të stabilimentit dhe kur mbingarkesa mund të shmanget me shkyçje automatike apo manuale brenda kohës së lejueshme nominale të stabilimentit.

3.5 Restaurimi i sigurisë së sistemit pas prishjes

3.5.1.1 Pas shfaqjes së një ndërprerje nga një prishje permanente, **OST** duhet të ndërmerri masat në pajtim me obligimet e tij sipas **Kodit të Rrjetit**, për të restauruar sistemin sa më parë që është e mundur në kriteret operative të lartshënuara. Kështu që **OST** duhet të ketë plane në mënyrë që të lehtësoj restaurimin e shpejtë të sigurisë së sistemit.

	STANDARDET E SIGURISË SË OPERIMIT	PO-KO-007
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faqe 9 nga 14</i>

3.6 Kushtet e ndërprerjes

3.6.1 Rrjeti 400 kV

3.6.1.1 **Ndërprerjet** e planifikuara në rrjetin 400 kV duhet të bëhen ashtu që rrjeti 400kV mund të operohet që të përmbush **kriterin ‘N-1’** dhe të përmbush kërkesat e paragrafëve 3.2.1.1 dhe 3.2.1.2

3.6.1.2 Për linjat interkonektive 400 kV **ndërprerjet** e tyre duhet të koordinohen me palët tjera në pajtim me **marrëveshjet interkonektive** përkatëse dhe **kodin e planifikimit operativ të Kodit të Rrjetit.**

3.6.2 Rrjeti 220 kV

3.6.2.1 Ndërprerjet e planifikuara në rrjetin 220 kV duhet të bëhen ashtu që rrjeti 220 kV mund të operohet, aq sa është e mundur, për të përmbushur **kriterin ‘N-1’** dhe kërkesat e paragrafëve 3.2.1.1 dhe 3.2.1.2.

3.6.2.2 Për rrjetin 220 kV **ndërprerjet** e linjave të transmisionit, të cilat janë interkonekcion ndërshtetëror dhe të gjitha **ndërprerjet e linjave 220 kV**, duhet të koordinohen me palët tjera në pajtim me **marrëveshjen interkonektive** përkatëse dhe **kodin e planifikimit operativ të Kodit të Rrjetit.**

3.6.3 Rrjeti 110 kV

3.6.3.1 Ndërprerjet e planifikuara në rrjetin 110 kV duhet të bëhen ashtu që rrjeti 110 kV të operohet aq sa është e mundur për të përmbushur **kriterin ‘N-1’** dhe kërkesat e paragrafëve 3.2.1.1 dhe 3.2.1.2

3.6.3.2 Për rrjetin 110 kV, **ndërprerjet** e linjave të transmisionit të cilat ndërlidhen me shtetet tjera dhe **ndërprerjet e qarqeve** relevante duhet të koordinohen me palët tjera në pajtim me **marrëveshjen interkonektive** përkatëse dhe **kodin e planifikimit operativ të Kodit të Rrjetit.**

3.6.3.3 Për transformatorët të nënstacioneve ekzistuese 220 kV dhe 110 kV në të cilat kyçen në nivelet e tensioneve 35 kV dhe 10(20) kV dhe të cilat janë në pronësi të KOSTT, plotësimi i kriterit N-1 nuk do të mund të plotësohet për një periudë kohore të

	STANDARDET E SIGURISË SË OPERIMIT	PO-KO-007
	<i>ver. 1.3</i>	<i>fajqe 10 nga 14</i>

papërcaktuar¹, për shkaqe tekniko-ekonomike dhe nuk paraqet zgjidhjen teknike të pranueshme për shkak të kostos së lartë. Për rastet e ndërprerjeve të planifikuara dhe të nënstacionet ku kriteri N-1 nuk plotësohet, harmonizimi do të bëhet me OSSH ashtu që ndërprerjet të planifikohen në perioda kur ngarkesa është e ulët. Për konsumator me rëndësi të veçantë në harmonizim me OSSH-në rezerva e përkohshme transformuese sigurohet nga kapacitetet e rrjetit të tensionit të mesëm. Aranzhimi i tillë nëse teknikisht është i mundshëm bëhet me ndërlidhje të rrjetit të tensionit të mesëm nga dy nënstacione të ndryshme me shfrytëzimin edhe të NS 35/10(20) kV (për tensione të ndryshme të TM) apo përmes linjave ajrore/kabllove (për tensione të njëjta të TM), të cilat në kushte normale shërbejnë si lidhje unazore rezervë.

3.6.4 Operimi në kushtet e ndërprerjes

3.6.4.1 Për një numër të situatave të ndërprerjeve në rrjetin 110 kV dhe 220 kV të prezantuara në **Planin Zhvillimor të Transmisionit, kriteri 'N-1'** nuk mund të plotësohet gjatë ndërprerjeve të planifikuara. Në këto situata, sistemi duhet të operohet në mënyrë që të përmbushë kriteret vijuese sipas prioriteteve në vijim:

- a) Garantimi i sigurisë së punëtorëve dhe njerëzve të tjerë;
- b) Sigurimi që stabilimenti nuk operohet në atë mënyrë e cila do ta dëmtonte atë;
- c) Përmbush për aq sa është e mundur kërkesat e sistemit;
- d) Mirëmbaj tensionin e sistemit brenda kufijve të specifikuar në **Kodin e Rrjetit**;
- e) Operoj për të plotësuar **kriterin 'N-1'**:

3.6.4.2 Për një numër të qarqeve, veçanërisht në rrjetin 220kV furnizimi i nënstacioneve të caktuara nën kushte të **ndërprerjes**, mundet të mirëmbahet vetëm nëpërmjet një interkoneksioni ndërshtetëror dhe prandaj **ndërprerjet** duhet të koordinohen me palët tjera në pajtim me **marrëveshjen interkonektive** përkatëse dhe **kodin e planifikimit operativ të Kodit të Rrjetit**.

¹ ZRrE përcakton kohën e derogimit të këtij kriteri

	STANDARDET E SIGURISË SË OPERIMIT	PO-KO-007
	<i>ver. 1.3</i>	<i>fajqe 11 nga 14</i>

3.7 Restaurimi i sistemit

3.7.1 Kërkesat e Kodit të Rrjetit

3.7.1.1 Secila kërkesë për **ndërprerje** duhet të përmbajë informatat të cilat janë të kërkuara me **Kodin e Rrjetit** dhe kjo duhet të përfshijë detajet e kohës së restaurimit emergjent në fazat e ndryshme të **ndërprerjes** dhe konfirmimin se ekziston një plan rezervë për restaurimin emergjent.

3.7.2 Prishjet permanente

3.7.2.1 Në rast të një prishje permanente e cila shkakton humbje të ngarkesës, **OST** duhet të ketë plane dhe aranzhmane në mënyrë që të mundësoj sa më shumë të jetë praktikisht e mundur që kërkesa të restaurohet sa më shpejtë. **OST** duhet të bëjë përpjekjet maksimale që të restauroj tërë kërkesën sa më shpejt të jetë e mundur duke përdorur të gjitha resurset të cilat janë në dispozicion.

3.8 Ballafaqimi me mot të lig

3.8.1.1 Nën kushte të motit të lig ose parashikim të motit të lig, **OST** duhet të ndërmerret cilat do masa që konsideron të nevojshme në mënyrë që të mbrojë integritetin e rrjetit dhe në rast të ndërprerjeve permanente, të restauroj në gjendjen normale sa më shpejt të jetë e mundur. Kjo mund të përfshijë gatishmërinë e punëtorëve, aranzhmanet e mbështetjes dhe koordinimit me OST-të fqinje, restaurimin në punë të linjave që janë jashtë punës, etj.

3.9 Kufizimet gjate operimit

3.9.1.1 **OST** duhet të operoj **sistemin e transmisionit** në mënyrë të sigurtë, stabile dhe të padëmshme si dhe duke përmbushur të gjitha kërkesat e përdoruesve (**gjenerimin dhe kërkesën**) dhe duke mundësuar funksionimin e tregut të energjisë elektrike.

3.9.1.2 Sidoqoftë mund të ketë situata kur për shkak të pengesave në sistem nuk do të jetë e mundur për të lehtësuar tregun e **energjisë elektrike** dhe për të arritur sigurinë e sistemit. Nën këto kushte siguria e sistemit duhet të ketë prioritet ndaj përmbushjes së kërkesave të **pjesëmarrësve të tregut**.

3.10 Kufijtë e tensionit

3.10.1 Të përgjithshme

	STANDARDET E SIGURISË SË OPERIMIT	PO-KO-007
	<i>ver. 1.3</i>	<i>fajqe 12 nga 14</i>

3.10.1.1 Gjatë tërë kohës nën kushtet normale dhe të **ndërprerjes, Sistemi i Transmisionit** duhet të operohet për të përmbushur kufijtë e tensionit të specifikuar në **kodin e balancit të Kodit të Rrjetit**. Në kushtet normale dhe të **ndërprerjes**, një pasiguri e vetme përfshirë një ndërprerje nga prishja e një linje, **njësie gjeneruese**, burime të fuqisë, shant reaktor ose kapacitor nuk duhet të thyej kërkesat e seksioneve 3.10.2 dhe 3.10.3.

3.10.2 Kufijtë e jashtëzakonshëm

3.10.2.1 Sistemi duhet të operohet ashtu që çdo ndryshim i shpejtë i tensionit pas një prishje ose ngjarje tjetër të rëndësishme nuk duhet të jetë jashtë kufijve për rrethana të jashtëzakonshme të specifikuara në **kodin e balancit të Kodit të Rrjetit**.

3.10.3 Kufijtë normal

3.10.3.1 Pas një ndryshimi të shpejtë të tensionit siç specifikohet më lartë, duhet të ndërmerren veprime automatike dhe manuale për të restauruar tensionin brenda 10 minutave brenda kufijve normal të specifikuar në **kodin e balancit të Kodit të Rrjetit**.

3.10.4 Dështimi për të përmbushur kufijtë e tensionit

3.10.4.1 Ekziston një numër i lokacioneve në rrjetin 110 kV ku kufijtë e tensionit për rrethanat normale nuk mund të mirëmbahen gjatë tërë kohës nën kushte normale të sistemit. Në këto rrethana sistemi duhet të operohet me prioritetet vijuese:

- Garantimi i sigurisë së personelit;
- Sigurimi që stabilimenti nuk operohet në atë mënyrë e cila do ta dëmtonte atë;
- Siguroj që një ngjarje e vetme shtesë nuk shpie në një rënie më të gjerë në sistemin e transmisionit;
- Përmbush aq sa është e mundur kërkesën e sistemit;

3.11 Konfigurimi i zbarrave

3.11.1 Të përgjithshme

3.11.1.1 Në selektimin e konfigurimit më të mirë të zbarrave, për operim normal ose gjatë kushteve të ndërprerjeve të planifikuara, është e nevojshme që të konsiderohen efektet e mundshme të çfarëdo prishjejetë mundëshme dhe për të adaptuar konfigurimin i cili ofron sigurinë më të mirë të përgjithshme, nëse është e nevojshme duke e kufizuar nivelin e prishjeve të sistemit.

	STANDARDET E SIGURISË SË OPERIMIT	PO-KO-007
	<i>ver. 1.3</i>	<i>fajqe 13 nga 14</i>

3.11.1.2 Linjat dhe transformatorët duhet të shpërndahen përgjatë zbarrave në dispozicion në atë mënyrë që ndikimi i një prishjeje të zbarrës të jetë sa më i kufizuar që është e mundur.

3.11.1.3 Konfigurimi i zgjedhur duhet të merr parasysh mundësinë e prishjeve sipas rendit të një qarku ose një gjeneratori të vetëm, një seksioni të vetëm të zbarrave, dy prishje koincidente ose dy seksione të zbarrës.

4 Kushtet e Përgjithshme

4.1 Procedura e kontesteve

4.1.1.1 Kontestet që dalin nga aplikimi i këtyre standardeve të sigurisë së operimit duhet të trajtohen në pajtim me dispozitat e **Kodit të Rrjetit** dhe me **Rregullën për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë**, të miratuar nga **ZRrE** si mënyrë për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet palëve në tregun e energjisë.

4.2 Ndryshimet e standardeve të sigurisë së operimit

4.2.1.1 **Operatori i sistemit të transmisionit** është përgjegjës për administrimin e të gjitha kodeve teknike dhe standardeve relevante për energjinë elektrike, të cilat kërkohen sipas dispozitave të licencës së **OST**. Këtu përfshihen standardet e sigurisë së operimit, të cilat janë të kushtëzuara me miratimin e **ZRrE** para implementimit të tyre.

4.2.1.2 **OST** do të rishqyrtojë herë pas here zbatimin e Standardeve të Sigurisë së Operimit dhe nëse ka ndryshime të këtyre standardeve, do t'i propozohen **Komisionit për Qeverisjen e Kodeve Operacionale (KQKO)** i themeluar në pajtim me procedurën e menaxhimit të kodeve teknike/operacionale të miratuar nga **ZRrE**. Ndryshimet e aprovuara nga **KQKO** dërgohen për aprovim në **ZRrE**

4.2.1.3 **OST** duhet të marr përgjegjësinë për inkorporimin e ndryshimeve të cilat janë miratuar nga **ZRrE** dhe për publikimin e dokumentit të ndryshuar në web faqe.

4.3 Rrethanat e paparashikuara

4.3.1.1 **OST** do të operoj **sistemin e transmisionit** në pajtim me këto standarde të sigurisë së operimit si dhe kodet e standardeve tjera. Nëse në mënyrë të arsyeshme paraqitet situata e cila nuk është parashikuar, atëherë **OST** do të veproj sipas dispozitave për rrethanat e paparashikuara të **Kodit të Rrjetit**.

	STANDARDET E SIGURISË SË OPERIMIT	PO-KO-007
	<i>ver. 1.3</i>	<i>faje 14 nga 14</i>

5 Burimet dhe dokumentet

5.1 Burimet

Nr.	Emri i dokumentit
1.	Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmisionit
2.	Plani Zhvillimor i Transmisionit (dhjetëvjeçar)
3.	Kodi i Rrjetit
4.	

5.2 Dokumentet dhe formularët

5.3 Shënime për versionet

Versioni	Data	Përshkrimi	Kohëruajtja
1.1	24.06.2008	Edicioni 1, Rishikimi 1	3 vjet
1.2	28.01.2011	Edicioni 1, Rishikimi 2	3 vjet
1.3		Edicioni 1, Rishikimi 3	